



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.9.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR ME QASJE PROGRAMATIKE ME SHUMË FAZA”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”, në mbledhjen e tij të datës 10 shtator 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Andrea MARTO.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza, në shumën prej 17 600 000 eurosh.

Projekti “Për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza” është pjesë e fazës së parë të një programi të përbashkët rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky program synon të ndihmojë qeveritë e këtyre vendeve për të ulur kostot e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit përmes angazhimit afatgjatë, adaptiv dhe të vazhdueshëm.

Ky Projekt është i ndarë në dy faza me një periudhë pesë vjet secila, ku Faza 1 mbulon tre nga vendet e Ballkanit Perëndimor, konkretisht Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë, dhe do të përfshijë një kombinim të investimeve, asistencës teknike dhe reformave rregullatore e institucionale, ndërsa Faza 2 përfshin tre vendet e tjera të rajonit, konkretisht Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

Projekti “Për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza” përbëhet nga 4 pjesë që lidhen konkretisht me:

- Lehtësimin e lëvizjes së mallrave në mbarë Ballkanin Perëndimor;
- Rritjen e efikasitetit dhe parashikueshmërisë së transportit;
- Rritjen e qasjes të tregtisë në tregun e shërbimeve dhe të investimeve; dhe
- Mbështetjen për zbatimin e Projektit

Huaja e siguruar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) është në shumën 17.6 milionë euro dhe ka termat e mëposhtëm:

Interesi:	normë reference + marzh të pandryshueshëm;
Tarifa <i>Front-end</i> :	0.25% e shumës së huasë;
Komision angazhimi:	0.25% që përlogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas;
Maturimi:	23 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përafron ndonjë legjislacion të BE-së.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që kjo hua krijon mundësinë për qeverinë shqiptare për të ulur kostot e tregtisë dhe për të rritur efikasitetin e transportit përmes angazhimit afatgjatë, adaptiv dhe të vazhdueshëm.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor të kësaj marrëveshjeje duke theksuar që zbatimi i këtij projekti kjo do sjellë efekte pozitive në tregtinë dhe ekonominë shqiptare në përgjithësi.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në nevojën e kësaj huaje, benefitet e Shqipërisë nga ky projektet, efektet konkrete që do ketë në ekonominë e vendit, si dhe në investimet specifike të projektit në fjalë.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për të ulur kostot e tregtisë dhe për të rritur efikasitetin e transportit.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Andrea MARTO

Niko PELESHI

Relator

Kryetar